



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
**Skupšina Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec**



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e komitetit për arsim e mbajtur me datë 19.09.2022 (e hënë) me fillim në ora 14:00. Mbledhjen e parë e kryesoi anëtar më i vjetër z. Xhevdet Morina nga gjithsej pesë (5) anëtarë që janë në këtë komitet. Të gjithë anëtarët ishin prezent në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite;

**R E N D D I T E**

1. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për arsim;
2. Të ndryshme;

**Kryesuesi** – Përshëndetje për të gjithë anëtarët e komitetit për arsim. Unë jam Xhevdet Morina i zgjedhur si anëtar i këtij komiteti. Pa humbur kohë, rendi i ditës i ka dy pikat;

**1.Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për arsim;**

Sa i përket pikës së parë duhet t'a kemi një propozim për kryesues/e?...

**Leonard Morina** – Faleminderit, unë propozoj si kryesues e këtij komiteti të jetë zonja Fahrije Lushi.

**Kryesuesi** – Atëherë faleminderit, ndonjë propozim tjeter?...Po, Alban.

**Alban Bajraktari** – Përshëndetje për të gjithë, mendoj që çdo propozim tjeter do të ishte i pakuptimitë në këtë rast, nuk kam asgjë kundër këtij propozimi, pajtohem plotësisht, Fahrija mund të jep kontribut të mirë në këtë pozitë.

**Kryesuesi** – Atëherë këtë propozim po e vendosim në votim, kush është për?... Në mënyrë unanim konstatoj që Fahrije Lushi është kryesuese e komitetit për arsim. E lusim t'a zë vendin e kryesueses.

**Fahrije Lushi** – Faleminderit shumë për kontributin që më zgjodhët në krye të këtij komiteti. Shpresoj të kemi konsensus dhe bashkëpunim të hapur duke ndihmuar rrjedhën e komitetit për arsim.

**2.Të ndryshme;**

**Leonard Morina** – Faleminderit, kisha pas dëshirë që në diskutim t'a fusim temën se sa takime do t'i kemi deri në fund të vitit kalendarik.

**Alban Bajraktari** – Urime për kryesuesen, besoj që do të jepni kontribut të mirë prej asaj pozite. Sa i përket takimeve do të ishte e udhës që deri në fundvit t'i kemi edhe 3 takime tjera ose edhe 4, pse jo?... Sfera e arsimit ka mjaftë tema që duhet të diskutohen e shqyrtohen.

**Fahrije Lushi** – Atëherë meqë janë kërkesat e të gjithëve të pranishëm, e fusim në votim dhe po del që në mënyrë unanim komiteti ka vendosur të mbahen + 3 takime deri në fund të vitit apo një herë në muaj. Atëherë këtu po e përmbyllim takimin e parë, faleminderit shumë dhe shihemi pas një muaji.

Mbledhja ka përfunduar në ora 14:15

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

